



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 21/11

Prishtinë, më 25.07.2011, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Latif Gashi, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza-MF, Aleksander Beetz, Ramadan Islami nga GIZ, monitorues nga KDI, OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i propozim – amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit,
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-45 për Partneritet Publiko-Privat;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-015 për ndihmë juridike falas, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-017 për mbrojtjen e dëshmitarëve, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për rendin e ditës.

Naser Osmani, theksoi se megjithëse grupi punues ka kryer punën e vet në amendamentimin e projektligjit për akcizën në produktet e duhanit, duke marr parasysh sugjerimet dhe vërejtjet e arsyeshme, që kanë dalur nga interesuarve që ndërlidhen me këtë projektligj, kërkohet kohë shtesë në rishqyrtimin të këtij drafti dhe propozoi që pika e dytë e rendit të ditës, të shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit.

Kryetarja, duke u lidhur me parafolësin, theksoi se ju keni qen qen qenë edhe referues i grupit punueses dhe më së miri e vlerësoni rëndësinë nevojën për të vazhduar punën në amendamentimin e projektligjit.

Pas votimit, rendi i ditës njëzëri miratohet me ndryshime. Pika e 2 e rendit të ditës shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit. Në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-45 për Partneritet Publiko-Privat

Bedri Hamza, duke marrë parasysh ndryshimet politike, ekonomike dhe juridike që kanë ndodhur nga koha e miratimit të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat dhe Koncesionet dhe pasi që është vërejtur se ligji ekzistues, ndryshon nga Acquis communitarie, ministria e financave ka draftuar projektligjin e ri që është në përputhje me direktivat evropiane për këtë qëllim. Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore dhe procedurave për të hyrë në marrëveshje publiko-privat dhe për menaxhimin dhe zhvillimin e partneritetit publiko private ne Republikën e Kosovës. Përmes keti projektligji ndryshohet përbërja e komisionit drejtuese per partneritetet publiko private ne mënyrë dhe roli i ministrisë së financave në këtë drejtim. Ky projektligje përputhet me standardet dhe pikat me te mira ndërkombëtare, ku veçanarisht janë marrë parasysh direktivat e BE-së në procedurat e veç jon prokurimit publik në dhënien e kontratave të partneriteti publiko-privat dhe garanton procedurat me më transparencën më të madhe.

Kryetarja, theksoi se struktura e projektligjit është e përgaditur mirë, është harmonizuar me direktivat e BE-së si tillë nuk përmban implikime buxhetore dhe përmbush kushtet e përgjithshme për miratim në lexim të parë në Kuvend.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet të miratojë në parim Projektligjin për Partneritet Publiko-Privat

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-015 për ndihmë juridike falas, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion

Kryetarja, theksoi se amendament e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, mirëpo bazuar në Deklaratën e Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, projektligji përmban një kosto buxhetore shtesë në kategoritë e caktuara ekonomike dhe në rritjen e numrit të punëtorëve, të cilat nuk janë planifikuara në buxhetin e vitit 2011 dhe KASH-in për vitin 2012-2014.

Naser Osmani, nëse projektligji ka implikime buxhetore, është vështirë si komision të arsyetohemi në Kuvend. Pas që është vlerësuar se projektligji ka implikime buxhetore, që ka të bëjë edhe me shtimin e numrit të të punësuarve, do të duhej që të mbajmë takim me komisionin funksional për të gjetur një

mundësi, që numër i punëtorëve të zvogëlohet dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme për që kanë efekt të drejtpërdrejt buxhetor dhe pastaj të procedohet për miratim në seancë plenare.

Kryetarja, gjithashtu theksoi se projektligji dhe amendamentet të mos miratohen në këtë mbledhje, deri sa të analizohen më mirë me komisionin për legjislacione me sponsoruesin, sidomos për rritjen e numrit të punëtorëve dhe të kuptohet sa është qëndrueshmëria që të sigurohen mjete buxhetore për këtë numër të punëtorëve, kur dihet se kemi rekomandime nga FMN, që mos të rritet numri i punëtorëve. Propozoj që të shtyhet në një mbledhje tjetër.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas, përmban implikime buxhetore shitesë, të vlerësuara në shumën prej 541,168 €, në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime dhe shpenzime kapitale, si dhe rritje të numrit të punëtorëve për tridhjetë pozita (për vitet 2011-2013), e cila kosto dhe numër shitesë i punëtorëve nuk janë të përfshira në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2012-2014.
2. Amendamente e propozuara nga Komisioni funksional për Legjislacion, për Projektligjin nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas, nuk përmbajnë implikime buxhetore shitesë.
3. I rekomandon Kuvendit të mos e miratoj projektligjin dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, për shkak të implikimeve buxhetore shitesë, që përmban projektligji.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-017 për mbrojtjen e dëshmitarëve, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion**

Kryetarja, theksoi se kemi të bëjmë me një projektligj të rëndësishëm që është kërkuar në vazhdimësi të miratohet. Përkundër se projektligji përmban implikime buxhetore shitesë, është e nevojshme të miratohet ky projektligj dhe rekomandimi i Komisionit do të ishte që të miratohet projektligji, por me që ai parashihet të hyn në fuqi pas një viti nga miratimi në Kuvend, pjesë e rekomandimit të komisioni, do të jetë kërkesa që qeveria gjatë fazës së përgatitjes dhe miratimit të buxhetit, të parashikojë mjete buxhetore në buxhetin e vitit 2012 dhe në KASH-in 2013-2015, për implementim e këtij ligji.

Hykmete Bajrami, theksoi se me rastin e lexim të parë, implikimet buxhetore të këtij projektligji ka qenë një çështje shumë diskutabile dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me institucionet të cilat themelohen për mbrojtjen e dëshmitarëve, por përfshin edhe kosto tjera siq janë operacionet plastike, ndërrimi i vendbanimit, ndërrimi i identitetit, të gjitha këto përmban një kosto shumë të lartë. Nuk kemi mjete buxhetore për të implementuar këtë projektligj.

Naser Osmani, vlerësoi se pasi që kemi të bëjmë me një projektligj të rëndësishëm së veçantë dhe meqenëse se ai pritet të hynë fuqi një vit pas miratimit, komisioni do të duhej të rekomandojë miratimin e projektligjit dhe qeveria të sigurojë mjete për implementimin e tij.

Xhevedet Neziraj, përkundër asaj që projektligji është i rëndësishëm, është e domosdoshme që në mënyrë më detale të trajtojmë koston buxhetore që bartë ky projektligj për të parë mundësinë e implementimit të tij. Kemi shumë ligje të cilat për shkak të koston së madhe buxhetore, nuk po zbatohen apo kanë vështërsi të zbatohen në praktikë.

Kryetarja, pasi që kemi të bëjmë me një projektligj të veçantë dhe është pjesë e projektligjeve që kërkohet të miratohen me raportin e progresit, duke ditur se disa mjete buxhetore janë paraparë, të rekomandojmë miratimin e këtij projektligji dhe qeveria me rastin e përgatitje dhe miratimit të buxhetit dhe KASH-it, të planifikojë mjete në për implementimin e tij.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamente e propozuara nga Komisioni funksional për Legjislacion, për Projektligjin nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
3. Kuvendi të miratoj projektligjin me amendamentet e propozuara dhe Qeveria në fazën e përgatitjes dhe miratimit të buxhetit për vitin 2012 dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2013-2015, të parashikoj mjete të mjaftueshme buxhetore dhe numër të punëtorëve, për implementimin e këtij ligji.

5. Të ndryshme.

Kryetarja, propozojë që të formohen dy grupe punuese, për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për Prokurimin Publik dhe Projektligjin për Partneritet Publiko-Privat, në mënyrë që të jemi të gatshëm të fillojmë punën pas leximit të parë dhe në rast se ato miratohen në seancë plenare. Pas propozimit të emrave të anëtarëve, u formuan dy grupe punuese.

Anëtarët e grupit punues për shqyrtimin e PL për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës:

1. Naser Osmani (raportues)
2. Latif Gashi
3. Hykmete Bajrami dhe
4. Duda Balje.

Anëtarët e grupit punues për shqyrtimin e PL për Partneritet Publiko-Privat:

5. Safete Hadërgjonaj (raportuese)
6. Jelena Bontic
7. Hasime Krasniq dhe
8. Sali Asllanaj dhe
9. Xhevdet Neziraj.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj